

STATUT E AKTHEMELIMI I SHOQËRISË TREGTARE
“LereiMusic” SH.P.K

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1:

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më (28/01/2021) (dymijë e njëzet e nje), ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“LereiMusic” SH.P.K.**

Themeluesi i shoqërisë është:

- **Z.Ergys Trimaçi ,lindur në datë 21/01/1989, në Shkoder, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar , mbajtës i kartës së identitetit Nr. I90121057J.**

Me vullnet të lirë të plotë si themeluesi i kësaj shoqërie në të cilën është ortak vendos të hartojë këtë Statut e Akt Themelimi mbështetur në nenet e mëposhtme si dhe në dispozitat ligjore si :

- Kodin Civil
- **LIGJIN ME NR 9901 DATË 14.04.2008 “PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE”**

Neni 2:

Objekti

- Import-export te pajisjeve muzikore;
- Tregeti me shumice e pakice te pajisjeve muzikore

Neni 3:

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë është e papërcaktuar duke filluar nga dita e regjistrimit në QKB, për njohjen dhe regjistrimin e shoqërisë si person juridik.

Neni 4:

Selia

Selia e shoqërisë **“LereiMusic” SH.P.K** është në Tirane, Njesia Bashkiake nr.5, Rruga Irfan Tomini, Hyrja 1, Ap6 .

Kreu II

Kapitali



Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali Themeltar i shoqërisë është 100 Lekë (njqind) formuar dhe nënshkruar nga ortakët i përbërë nga 1 kuotë si më poshtë:

- **Z.Ergys Trimaçi**, zotërues i 1 kuote, me pjesëmarrje në përqindje 100% me një kontribut prej 100 Lekë.

I depozituar dhe shlyer sipas ligjit në fuqi.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Ortakët kanë të drejtë në shpërndarjen e fitimeve (nëse ka fitime dhe kanë zbritur shumën që do përdoret si rezerva të detyrueshme të parashikuara nga ligji), në përpjesëtim me kuotat përkatëse.

Shoqëria përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali themeltar mund të rritet duke nënshkruar kapitalin në përpjesëtim me kuotat përkatëse.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- shitblerjes;
- trashëgimisë;
- dhurimit;
- çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Ortakët kanë të drejtë të transferojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë , pjesërisht apo tërësisht dividendët e tyre e përfshirë dhe fondet dhe kontributet e pjesëve të kapitalit themelor, duhet të jenë të vërtetuara me Akt Noterial dhe për një gjë të tillë vendimet e asamblesë së ortakëve të shoqërisë duhet të merren paraprakisht me shkrim.

Shoqëria dhe të tretët duhet të respektojnë këto transferime sapo t'u bëhen të ditura.

KREU III

ORGANET VENDIMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8

Asambleja e Ortakëve

Asambleja e Ortakëve është Organi më i Lartë Drejtues dhe Vendimor i shoqërisë dhe ai ushtron të gjitha kompetencat që njihen nga ligji në fuqi. çështjet e mëposhtme:

1. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
2. ndryshimet e statutit
3. emërimin e shkarkimin e administratorëve
4. emërimin e shkarkimin e likuiduesve;
5. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "3" dhe "4" të kësaj pike;
6. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
7. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
8. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
9. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
10. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
11. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
12. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
13. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Përfaqësimi duhet të jepet me shkrim, qoftë edhe me prokurë të thjeshtë, dhe dokumentet përkatëse duhet të mbahen në regjistrimet e kompanisë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mbledhja

Administratori mund të thërrasë Asamblenë e Ortakëve kur e gjykon të përshtatshme dhe kur i kërkohet nga Aksioneri / Aksioneret në përputhje me Nenin 84 të Ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ose anëtarët që përfaqësojnë të paktën 5 (pesë)% të totalit të votave të Asamblesë e Ortakëve.

Asambleja thirret me një njoftim që përmban ditën, orën dhe vendin e takimit, çështjet që do të diskutohen dhe, ndoshta, datën e thirrjes së dytë. Njoftimi i thirrjes komunikohet me letrën rekomande, ose me faks ose me e-mail në adresat e anëtarëve, të paktën 8 (tetë) ditë para datës së

caktuar për mbledhje, afat që mund të jetë edhe më i shkurtër nëse miratohet nga shumica e anëtarëve, të cilët nuk kanë më pak se 50 % e vlerës nominale të kuotave.

Çdo ndryshim i mëpasshëm në adresën e e-mailit ose adresës së faksit të anëtarit duhet t'i njoftohet Administratorit me shkrim. Përndryshe, çdo njoftim drejtuar Ortakve do të vazhdojë të ekzekutohet sipas të dhënave që Kompania ka në dispozicion dhe të cilat janë të deklaruara në këtë Statut dhe njoftimi do të konsiderohet i përfunduar.

Asambleja mund të zhvillohet me ndërhyrje të vendosura në më shumë se një vend, të afert ose të largët, audio ose video, me kusht që të respektohen mënyra kolegjiale dhe parimet e mirëbesimit dhe trajtimit të barabartë të anëtarëve. Në veçanti, do të jetë e nevojshme:

- Presidenti, gjithashtu përmes zyrës së tij, lejohet të konstatojë identitetin dhe legjitimitetin e të pranishmëve, të rregullojë ecurinë e takimit, të konstatojë dhe të shpall rezultatet e votimit;
- personi që merr procesverbalin lejohet që në mënyrë adekuate të perceptojë ngjarjet e takimit që i nënshtrohen procesverbalit;
- të pranishmit lejohen të marrin pjesë në diskutim dhe votim të njëkohshëm në pikat në rendin e ditës.

Neni 10

Kuorumi

Asambleja e ortakëve vendos në mënyrë të vlefshme në asamblenë e jashtëzakonshme, pas arritjes së kuorumit prej së paku 51% të anëtarëve të shoqërisë dhe asambleja vendos me së paku $\frac{3}{4}$ të votave të anëtarëve të pranishëm për çështjet e mëposhtme

- për ndryshimin e statutit;
- zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
- shpërndarjen e fitimeve;
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë:

Asambleja e ortakëve vendos në mënyrë të vlefshme në asamblenë e zakonshme për të gjitha çështjet e tjera, me arritjen e kuorumit prej së paku 51% dhe vendos me të paktën mbi gjysmën e numrit të përgjithshëm të votave të anëtarëve të pranishëm.

Nëse Asambleja e ortakëve nuk mund të përmbushë për shkak të mungesës së kuorumit të lartpërmendur, asambleja do të mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtën rend dite.

Neni 11

Emërimi i Administratorit

Adminstrator i shoqërisë është :

- **Z. Ergys Trimaçi , lindur në datë 21/01/1989 , në Shkoder, madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar , mbajtës i kartës së identitetit Nr. I90121057J.**

Afati i emërimit, është 5 vjet i cili fillon nga momenti i depozitimit të këtij statuti në QKB dhe regjistrimit të shoqërisë .



Neni 12

Kompetencat e Administratorit

Administratori ka këto të drejta dhe detyra:

- të kryejë të gjitha veprimet në lidhje me administrimin e aktivitetit tregtar të kompanisë;
- përfaqëson kompaninë;
- mbajtjen korrekte të dokumenteve të kompanisë dhe të librave të kontabilitetit;
- përgatitjen dhe nënshkrimin e pasqyrave vjetore financiare, pasqyrave financiare të konsoliduara dhe raportet mbi ecurinë e aktivitetit, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve dhe sjelljen e këtyre dokumenteve në Asamble për miratim.
- të përfaqësojë kompaninë në mënyrë aktive ose pasive para çdo autoriteti gjyqësor, administrativ, fiskal në cilëndo procedurë në çdo fazë të gjykimit, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, me të drejtë të nënshkruajë çdo dokument ose dokument të kërkuar sipas rasteve, personalisht ose duke ndjekur formalitetet përkatëse, duke përfshirë prokurat, mandatet për avokatët, konsulentët ose palët e treta
- krijimi i një sistemi paralajmërues në kohën e duhur për çështjet që kërcënojnë mbarevajtjen e biznesit dhe ekzistencën e kompanisë
- të nënshkruajë kontrata të ndryshme për shitjen, blerjen, këmbimin ose dhënien me qira të pasurive të ndryshme (të luajtshme dhe të paluajtshme), si me personat fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, ashtu edhe me Shtetin dhe në rast të blerjes së pronave të paluajtshme të bëj transkriptimin e pronës së tij në favor të tij në zyrën "Hipotekë" dhe ZRPPP për të dokumentuar një rrethanë të tillë, si dhe një rritje në kapitalin e tyre në natyrë.
- të bëjë të gjitha llojet e veprimeve në të gjitha zyrat private dhe shtetërore, dhe në banka.
- të hap llogari bankare për shoqërinë pranë çdo banke të nivelit të dytë që operon në Republikën e Shqipërisë .
- të punësojë, pezullojë, shkarkojë dhe modifikojë kushtet që lidhen me marrëdhëniet e punësimit të stafit;
- të kryejë detyra të tjera të përcaktuara me ligj ose statut.

NENI 13

Përgjegjësitë e administratorit

Administratori është i detyruar të kompensojë shoqërinë për dëmet e pësuar, në rast se, në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 9901 të datës 14/04/2008 dhe ndryshimet pasuese, kryen veprimet e mëposhtme.

- Kthimi i kontributeve për anëtarët
- Pagan interesa ose dividendë për anëtarët
- Shpërndan asetet e kompanisë
- I lejon kompanisë të vazhdojë aktivitetin tregtar, kur, bazuar në gjendjen financiare, pritet që kompania të mos ketë kapacitet paguese
- jep kredi

KREU IV

BILANCI, TË ARDHURAT DHE SHPËRNDARJA E KOMPANISË

NENI 14

Bilanci

Veprimet ekonomiko-financiare të kompanisë fillojnë në 1 Janar dhe mbyllen më 31 Dhjetor të çdo viti, me përjashtim të vitit të parë që fillon nga data e regjistrimit të kompanisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Rezultati i pasqyrave financiare vjetore duhet të përpilohet sipas rregullave të përcaktuara nga ligji i taksave dhe ai i kontabilitetit.

Pasqyrat financiare miratohen me rezolutë me shkrim të Asamblese së ortakëve, e cila gjithashtu vendos për disponueshmërinë e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të mëtejshëm të shoqërisë, duke pasur parasysh fondin rezervë, fondin e veçantë etj.

NENI 15

Shkrirja dhe likuidimi

Kompania mund të shpërbëhet në çdo kohë, madje edhe para skadimit të afatit për të cilin është themeluar, për shkaqet e mëposhtme:

- Humbja e kapitalit dhe pamundësia e vazhdimit të mëtejshëm të aktivitetit;
- Për rastet e parashikuara nga ligji "Për falimentimin e shoqërive tregtare";
- Për shkak të përfundimit të afatit të përcaktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

Në këtë rast, Asambleja e Ortakëve vendos me shkrim ku parashikon edhe likuidimin e kompanisë duke emëruar një ose më shumë likuidatorë dhe duke cituar në secilin dokument emërtimin e likuidatorit dhe shënimin shtesë "Kompani në Likuidim".

NENI 16

Çdo mosmarrëveshje apo konflikt që mund të lindë gjatë veprimtarisë së shoqërisë si rregull dhe në përgjithësi ortakët duhet ta zgjidhin atë me mirëkuptim. Përndryshe, çështja bëhet objekt i konfliktit gjyqësor në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor të Tiranës.

NENI 17

Për çfarë nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut, i bëhet referim dispozitave ligjore në fuqi për këtë temë.

NENI 18



Përmbajtja e këtij statuti është shkruar në 3 kopje identike, në gjuhën shqipe dhe, me miratimin nga ana e anëtarëve themelues të shoqërisë të cdo neni, nënshkruhet në të gjitha kopjet me emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin origjinal.

THEMELUESI I SHOQËRISË TREGTARE

Z.Ergys Trimaçi

Ergys Trimaçi
